



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura V**

**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 49

Prishtinë, më 25.1.2017, në ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Xhevahire Izmaku, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Zenun Pajaziti, Agim Kikaj, Shqipe Pantina, Lahi Brahimaj dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Jelena Bontiq.

Në mbledhje morën pjesë: Ibrahim Rrustemi- ASK, përfaqësuesit e OSCE, KDI-së, RTK2, Radio Kosova, Koha Ditore, Ekonomia online dhe asistentet e grupeve parlamentare.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Xhevahire Izmaku, kryetare e Komisionit, me këtë rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit, për vitin 2017;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës;**
- 4. Miratimi i Projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr.04/L-046 për RTK-në;**
- 5. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetarja e komisionit, propozoi që rendi i ditës të ndryshohet si në vijim:

P/ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat zyrtare, të shqyrtohet si pikë e dytë e rendit të ditës, ndërsa raportimi i grupit punues për ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin e RTK-së të shtyhet për mbledhjen e radhës, lidhur me këtë

**Shqipe Pantina**, në cilësinë e anëtares së grupit punues, njoftoi komisionin se grupi punues nuk është dakorduar për disa çështje të caktuara, për të cilat kërkohet miratimi i komisionit.

**Lahi Brahimaj** pyeti se a është takuar grupi punues me Kryeministrin, ashtu siç ka vendosur komisioni dhe kërkoi nga grupi punues që të selektojnë çështjet për të cilat janë pajtuar që të ndryshohen në Ligjin për RTK-në dhe ato për të cilat nuk janë pajtuar.

**Sadri Ferati** propozoi që pas votimit të plotësim ndryshimeve në Ligjin për RTK-në të ftohet bordi në takim.

Pas diskutimeve të lartcekura, kryetarja e Komisionit kërkoi që të votohet ndryshimi i rendit të ditës sipas propozimit që të shqyrtohet P/ligji para miratimit në parim, dhe shqyrtimi i planit të punës së komisionit.

Rendi i ditës u miratua njëzëri.

## **2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-133 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës;**

Kryetarja e komisionit prezantoi z kryshëfin e ASK-së z. Ibrahim Rrustemin.

**Ibrahim Rrustemi**, zëvendëskryeshef i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, prezantoi vërejtjet e ASK-së në tekstin e Projektligjit:

Njoftoi komisionin për bashkëpunimin e ngushtë të ASK-së me Eurostatin, një agjenci që realizon misione të ndryshme në vende të ndryshme, mbi bazë të të cilave misione jep rekomandime për përmirësime në sistemin e statistikave. Një ndër rekomandimet e Eurostatit ka qenë edhe plotësim - ndryshimi i Ligjit në fuqi, sipas standardeve evropiane. Drafti për plotësim ndryshim është hartuar nga ASK-ja, sipas rekomandimeve të Eurostatit dhe është adresuar në Qeveri në vitin 2015, por drafti i ASK-së nuk është marrë parasysh nga qeveria. Drafti tani që është për shqyrtim para miratimit në parim, është përtej draftit të ASK-së adresuar Qeverisë. Sipas draftit, ASK-ja i raporton Kuvendit për dallim që me ligjin në fuqi i raporton Kryeministrit pastaj ka ndryshime edhe tek mandati i kryeshefit. Këto ndryshime kanë ngritur reagimet e Eurostatit, ndryshime këto që nuk janë konform standardeve evropiane.

**Sadri Ferati** propozoi që P/ligji, me gjithë vërejtjet, të miratohet në parim dhe pastaj në mes të leximeve të propozohen amendamente.

**Shqipe Pantina** propozoi që P/ligji të kthehet në Qeveri për ripunim . Ajo pati vërejtje në nenet 3, 4, 10 dhe 13, ndërsa u pajtua me tekstin e draftit që ASK-ja duhet të raportojë në Kuvend.

**Lahi Brahimaj** u pajtua me propozimin e znj. Shqipe Pantina, që draft- ligji të kthehet në Qeveri për ripunim.

**Zafir Berisha** përkrahu propozimet që P/ligji të kthehet në Qeveri për ripunim.

**Zenun Pajaziti** u deklarua që P/ligji të miratohet në parim.

**Konstatim:** Komisioni me 4 vota “Për”, 2 “Abstenime” dhe 1 “Kundër” miratoi në parim P/ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.

### **3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit, për vitin 2017;**

**Kryetarja e komisionit,** njoftoi komisionin që draft-plani i punës është hartuar mbi bazë të strategjisë legislative të Qeverisë, për vitin 2017 dhe sipas praktikave të punës mund të plotësohet dhe ndryshohet, varësisht prej çështjeve që mund të dalin si prioritet në punën e Komisionit.

Ajo kërkoi nga anëtarët e komisionit që të deklarohen po qe se kanë ndonjë propozim për t ë inkorporuar në plan të punës.

**Kujtim Paçaku** propozoi që në planin e punës të inkorporohet kërkesa e tij që komisioni të vizitojë Komunën e Prizrenit, lidhur me përdorimin e gjuhëve tradicionale në nivel komunal.

**Konstatim:** Kërkesën e z. Kujtim Paçaku, komisioni e miratoi dhe e inkorporoo në plan të punës, si aktivitet të komisionit për muajin shkurt.

**Shqipe Pantina** propozoi që në plan të inkorporohet edhe vizita e komisionit në komuna dhe raportimi i ministrave të ministrive që komisioni i mbikëqyrë.

**Xhevahire Izmaku, kryetare e Komisionit,** u përgjigj, se raportimi i ministrave caktohet sipas kërkesës së komisionit, sa herë që komisioni vendos, gjithashtu edhe për vizitën në komuna rreth monitorimit të ligjeve.

Lidhur me këtë kërkesë, komisioni kërkoi nga Shqipe Pantina që kërkesat e saj të qartësohen për cilat çështje kërkohet dhe të propozohen me shkrim, në mënyrë që pastaj të inkorporohen në planin e punës.

### **4. Të ndryshme .**

Komisioni propozoi që në mbledhjen e radhës, e cila u caktua për datën 26 janar 2017, të shqyrtohet pika e rendit të ditës e cila u shty, harmonizimi i propozim - ndryshimeve në Ligjin për RTK-në.

Mbledhja përfundoi në orën: 14:30.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Kryetarja e Komisionit,**

-----  
Xhevahire Izmaku